Summer 8-2020

CYBER SECURITY – PENETRATION TEST

Veton Bejtullahu
University for Business and Technology - UBT

Programi për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri

CYBER SECURITY – PENETRATION TEST

Bachelor

Veton Bejtullahu

Gusht / 2020

Prishtinë

Programi për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri

Punim Diplome
Viti akademik 2012 – 2013

Veton Bejtullahu

CYBER SECURITY – PENETRATION TEST

Mentori: Prof. Dr. Gazmend Krasniqi

Gusht / 2020

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjesshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Si pjesë e rritjes së vazhdueshme të një bote të ndërlidhur mes veti në internet, shteti, infrastrukturat, bizneset dhe të gjithë njerëzit varen nga funksionimi i besueshëm i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Liria dhe vlera e njerëzve në botën kibernetike duhet mbrojtur ashtu sikur në botën e jashtme. Me numrin e përdoruesve në internet gjithmonë në rritje dhe me teknologjitë e reja, numri i mundësive për sulm së bashku me kompleksitetin e sulmit, po rritet gjithashtu. Rreziku kryesor mbetet krimi kibernetik dhe rritja e tij reflektohet nga zhvillimi i shkathtësive të kriminelëve kibernetik dhe aftësia e tyre për të bërë sulme të organizuara.

Çdo hap i juaji në internet po gjurmohet dhe ruhet, dhe identiteti yt është vjedhur. Privatësia është një luks që pak persona mund ta përballojnë ose kuptojnë (Mitnick, 2017).

Vjedhja e informacionit konfidencial shpesh bëhet për përfitime materiale ose për dëmtime të qëllimshme. Disponueshmëria e lehtë e mjeteve të piraterisë në internet, pajisjet USB dhe lidhjet me Wi-Fi sigurojnë thyerje të lehta. Rezultati është humbje me vlerë prej miliona dollarësh në terma të vjedhjes së IP, rrjedhjes së informacionit të klientit apo individit, etj.

Ky material paraqet një kuptim të kërcënimeve të brendshme, sulmuesve dhe motivit të tyre, si dhe sugjeron teknika parandaluese ndaj sulmeve kibernetike.

MIRËNJOHJE DHE FALËNDERIME

Së pari falënderoj Kolegjin UBT që me programet e veta më mundësoi të studioj Shkencat Kompjuterike që i kam pasion të përjetshëm. Familjen time, që më mbështeti gjatë gjithë kohës dhe investoi jashtëzakonisht shumë në mua. Kolegët dhe miqtë e mi, me të cilët kalova pjesën më të rëndësishme të këtyre viteve të studimeve.

U jam shumë mirënjohës profesorëve dhe asistentëve në fakultet, për punën dhe rolin e tyre në aftësimin tim. Falënderoj veçanërisht mentorin Prof. Gazmend Krasniqi dhe co-mentorin Prof. Atdhe Buja që më ndihmuan dhe sugjeruan gjatë punimit të kësaj teme të diplomës. Ata gëzojnë nderimin tim të thellë.

PËRMBAJTJA

LISTA E FIGURAVE

LISTA E TABELAVE

FJALORI I TERMAVE

Wi-Fi – Wireless Fidelity

LAN –Local Area Network

WAN –Wide Area Network

HTTP – HyperText Transfer Protocol

URL – Uniform Resource Locator

DNS – Domain Name System

URL – Uniform Resource Locator

WLAN –Wireless Local Area Network

DHCP – Dynamic Host Configuration Protocol

HTML –Hypertext Markup Language

UI – User Interface

TLS – Transport Layer Security

SSL – Secure Sockets Layer

SQL – Structured Query Language

DOS – Disk Operating System

CSRF – Cross-Site Request Forgery

DDoS – Distributed Denial of Service

VPN – Virtual Private Network

VM – Virtual Machine

1. HYRJE

Në këtë temë do të flasim për Sigurinë Kibernetike, rëndësinë që ka informacioni dhe privatësia në ditët e sotme, si dhe mënyrat e mbrojtjes në internet.

Qeveritë dhe udhëheqësit e industrisë nga çdo sektor i madh njohin gjerësisht rëndësinë e forcimit të fushës së sigurisë kibernetike. Shkalla e zhvillimit teknologjik po prodhon një sfidë të madhe me ndryshim të shpejtë. Zhvillimet transformuese në fuqinë kompjuterike, cloud computing, celularë, inteligjencën artificiale, ndërlidhshmërinë e kudogjendur dhe sistemet e automatizuara në shkallë të gjerë po sjellin shqetësime të reja dhe të fuqishme për sigurinë kibernetike dhe privatësinë. Implikimet për kërcënimet e ardhshme për privatësinë dhe sigurinë janë të dëmshme dhe mund të jenë ndërlikim për dekadat që do të vijnë. Besimi i publikut në integritetin e sistemeve financiare globale, rrjeteve të informacionit dhe sistemeve të tjera të infrastrukturës kritike është thelbësor për rritjen e vazhdueshme ekonomike, sigurinë publike dhe inovacionin. Ruajtja dhe sigurimi i ekosistemeve digjitale të përmirësuara, të sigurta dhe të besueshme është jetik për të mbrojtur të dhënat organizative dhe personale kundër një vargu gjithnjë e më të madh të kërcënimeve (R. Jashari, 2018).

Si pjesë e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së këtyre sistemeve është Penetration Test, që shërben për njohjen dhe shfrytëzimin e nivelit të sigurisë së sistemeve në botën kibernetike.

Rasti i studimit në këtë temë do t'i kushtohet Web Application Penetration Testing, i cili na ndihmon të gjejmë dobësitë e webfaqeve të targetuara.

2. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Rrethanat e shtjellimit të kësaj teme janë problemet aktuale të shoqërisë tonë të cilat kanë të bëjnë direkt me keqpërdorimin e të dhënave dhe sigurinë e njerëzve në internet. Përfitimi i madh që vjen nga teknologjia, sjell gjithashtu rreziqet e mëdha që bëhen nga automatizimi i saj duke cënuar kështu privatësinë e çdo njërit prej nesh. Mungesa e njohurive nga shumica e njerëzve për Sigurinë Kibernetike paraqet problem të madh për ta dhe njëkohësisht ua lehtëson punën hakerëve të ndryshëm.

Sipas CISCO, mbi 30% e organizatave kanë përjetuar sulme kibernetike në infrastrukturën teknologjike të operimit. 100 mijë grupe në 150 shtete dhe më shumë se 400 mijë kompjuterë janë infektuar vetëm nga virusi WannaCry Ransomware në vitin 2017, i cili pastaj pësoi rënie të dukshme në vitin 2018. Megjithatë, në vitin paraprak kishte shkaktuar dëm prej 4 bilion dollarësh. Ky virus, së bashku me 90% e Malware-ve shpërndahet përmes e-mail.

Kosto e krimit kibernetik ka shtyrë organizatat që në vitin 2017 të shpenzojnë 23% më shumë se sa në vitin paraprak, një mesatare prej rreth 11 milion dollarë. Ndërsa kosto kohore për një sulm është 50 ditë. Më shumë se 53 mijë incidente të sigurisë kibernetike kanë ndodhur në vitin 2018. Deri në vitin 2021, parashihet që dëmi i shkaktuar të arrijë në 6 trilion dollarë. Komponenti më i shtrenjtë i një sulmi kibernetik është humbja e informacionit, që përfaqëson 43% të kostove. 41% e kompanive kanë mbi 1 mijë fajlla të ndjeshme duke përfshirë numra të kredit kartelave dhe të dhëna shëndetësore të cilat qëndrojnë të pambrojtura (Sobers, 2018).

Pra, problemi dhe sfida kryesore sot në botën e internetit është mbrojtja e të dhënave dhe parandalimi i hakimeve të tilla.

3. SHQYRTIMI I LITERATURËS

3.1 Çka është Penetration Testing?

Penetration Testing apo Pen Test është procesi i përpjekjes për të fituar qasje në burime pa dijeninë e emrit të përdoruesve, fjalëkalimeve dhe mjeteve të tjera normale të qasjes. Nëse fokusi është në burimet kompjuterike, atëherë shembujt e një depërtimi të suksesshëm do të ishin marrja ose shkatërrimi i dokumenteve konfidenciale, çmimeve, bazave të të dhënave dhe informatave të tjera të mbrojtura. Gjëja kryesore që e dallon një Penetration Tester nga një sulmues është autorizimi. Penetration Tester do të ketë leje nga pronari i atyre burimeve informatike që janë duke u testuar dhe do të jetë përgjegjës për të dhënë një raport.

3.2 Pse Penetration Testing?

Përkundër faktit që sulmet kibernetike janë rritur ndjeshëm, shumë kompani apo organizata sot ende nuk e monitorojnë sigurinë e infrastrukturës së tyre në mënyrë aktive dhe kështu mbesin një pre e lehtë për keqbërësit apo hakerët. Sapo të lidhen në internet, sistemet e kompanive mund të kontrollohen, skanohen apo edhe të sulmohen.

Qëllimi i testit të penetrimit është njohja e nivelit të sigurisë dhe rritja e sigurisë së burimeve informatike që testohen. Pra, një ndër hapat e parë drejt parandalimit të sulmeve kibernetike është pikërisht Penetration Test.

3.3 Benefitet e Penetration Testing?

Penetration testing lejon testuesit që të shikojnë sistemin e klientit përmes syve të hakerëve keqdashës. Një proces i tillë mund të sjellë një numër të madh zbulimesh dhe të i'a sigurojë klientit kohën e nevojshme që të riparojë sistemin para se të ndodhë sulmi në të vërtetë. Si shtesë, penetration testing mund të ndihmojë organizatat dhe kompanitë që të vërtetojnë efektivitetin apo mosefektivitetin e masave të sigurisë që janë implementuar, duke demonstruar në mënyrë eksplicite dobësitë e sigurisë në sistem. Për më me rëndësi, ky testim siguron evidencë për të alarmuar menaxhmentin për nevojën që ta marrë më seriozisht sigurinë e informacionit (Hardy, 1997).

3.4 Vulnerability Assessment dhe Penetration Test – Si bëhet një testim?

Vulnerability Assessment apo vlerësimi i cenueshmërisë dhe testimi i penetrimit është një proces total i 9 hapave, të cilët tregohen në figurën 1.

Para së gjithash, testuesi duhet të vendosë fushëveprimin e detyrës (black / grey / white box). Pas vendosjes së fushës, testuesi merr informacione për sistemin operativ, rrjetin dhe IP adresën në hapin e zbulimit. Pas kësaj, ai përdor teknika të ndryshme të vlerësimit të cenueshmërisë në objektin e testimit për të gjetur dobësi. Pastaj testuesi analizon dobësinë e gjetur dhe bën planin për testin e penetrimit. Testuesi përdor këtë plan për të depërtuar në sistemin e viktimës. Pas depërtimit në sistem, ai rrit privilegjin në sistem. Në hapin e analizës së rezultateve, testuesi analizon të gjitha rezultatet dhe përpilon rekomandime për të zgjidhur dobësitë që ka sistemi.

Të gjitha këto aktivitete dokumentohen dhe dërgohen tek menaxhmenti për të ndërmarrë veprimet e përshtatshme. Pas gjithë këtyre hapave, sistemi i viktimës dhe programi i tij preken dhe ndryshohen. Në hapin e pastrimit sistemi rivendoset në gjendjen e mëparshme ashtu siç ishte para fillimit të procesit (Goel, 2015).



Figura 1 – Cikli i Vulnerability Assessment dhe Penetration Testing

3.5 Metodologjitë dhe teknikat

3.5.1 Metodologjitë e penetration testing

Pasi që shumica e testeve të penetrimit të rrjetit apo sistemit ndajnë disa faza kryesore, shumë profesionistë të sigurisë kanë prezantuar metodologji të ndryshme për të kryer një test penetrimi duke filluar nga ato të thjeshta në proceset më të sofistikuara dhe formale.

Në përgjithësi, pen test përfshin tre faza kryesore që imitojnë hapat që do të përdoreshin nga hakerët e vërtetë për të kryer një sulm (Vacca, 2010). Tri fazat përkatëse janë: para-sulmi, sulmi dhe post-sulmi. Faza e para-sulmit tenton të hetojë ose të eksplorojë objektivin. Faza e sulmit përfshin thyerjen aktuale të objektivit. Së fundmi, faza e pas-sulmit, e cila është unike për ekipin e testimit të penetrimit, tenton të kthejë çdo sistem të modifikuar në fazën e mëparshme para fillimit të testeve (Phong, 2014).

Një metodologji bazike e Penetration testing përfshin 3 hapat e paraqitur në figurën 2.



Figura 2 – Metodologjia bazike e penetration testing

Reconnaissance (Zbulimi)

E njohur edhe si Mbledhja e Informacioneve, ky është procesi i kërkimit të informacionit në dispozicion që përdoret në penetration test. Varësisht nga fusha e testimit, aktivitetet e zbulimit mund të përfshijnë mbledhje të ping-ut për të zbuluar IP adresa në rrjet, marrje të informacionit të dobishëm nga punëtorët e kompanisë, hulumtim në mbeturinat e kompanisë për të gjetur fatura të telekomunikimit, e deri tek vjedhja, gënjimi i njerëzve, ndërhyrja në telefonata dhe rrjet. Kërkimi i informacionit është i limituar nga vullneti dhe sjelljet etike të dakorduara ndërmjet klientit dhe ekipit të penetrimit (Osborne, 2006).

Enumeration (Numërimi)

Ky është procesi ku informacioni fitohet direkt nga sistemi i targetuar, aplikacionet, dhe rrjetet me ndihmën e mjeteve (tools) dhe teknikave në mënyrë që të ndërtohet pamja e mjedisit të kompanisë. Numërimi i rrjetit krijon një pamje të konfigurimit të rrjetit që testohet, ndërsa numërimi pritës identifikon shërbimet në dispozicion në pajisje të ndryshme si firewalls, routerë dhe web server, dhe zbulon funksionet e tyre së bashku me hapjen e porteve që mund të përdoren për të depërtuar në sistem. Me anë të këtij procesi identifikohen dhe renditen edhe dobësitë potenciale (Shewmaker, 2008).

Exploitation (Shfrytëzimi)

Faza e shfrytëzimit përdor mjete të ndryshme të automatizuara, teknika dhe hapa manuale të rregulluara në mënyrë specifike për të kompromet uar sistemin përmes dobësive të identifikuara ose kanaleve të tjera që janë gjetur të hapura (Tiller, 2001). Qëllimi përfundimtar i këtij procesi është të sigurojë qasje administrative në sistem.

Ndërsa metodologjia më formale e penetration testing e ndërtuar rreth këtyre 3 hapave, zakonisht përfshin më shumë nën-aktivitete, të paraqitura në figurën 3.



Figura 3 – Metodologjia formale e penetration testing

Planning apo planifikimi është hapi i parë i cili ndikon në rezultatin e testimit. *Bootstrapping* është aktiviteti që starton procesin përsëri për të shikuar nëse ka dobësi të reja. Hapi më i rëndësishëm është *Reporting*, ku një raport i mirë duhet të përbëhet nga përshkrime të qarta të problemeve së bashku me ndikimet e tyre të mundshme, vlerësimi i nivelit të sigurisë, së bashku me numrin e rekomandimeve praktike për klientët për të zvogëluar apo mënjanuar në tërësi dobësitë e tilla.

3.5.2 Teknikat e penetration testing

Black box testing

Në këtë teknikë, testuesi nuk ka ndonjë njohuri paraprake të arkitekturës së rrjetit ose sistemeve të rrjetit të testimit. Zakonisht testimi black box kryhet nga rrjeti i jashtëm në rrjetin e brendshëm. Testuesi duhet të përdorë ekspertizën dhe aftësitë e tij për të kryer këtë testim.

Grey box testing

Në këtë teknikë, testuesi ka disa njohuri të pjesshme të rrjetit të testimit. Testuesi nuk ka njohuri për arkitekturën e plotë të rrjetit, por ai njeh disa informacione themelore për testimin e rrjetit dhe konfigurimin e sistemit. Në të vërtetë, testimi Grey box është kombinimi i dy teknikave të tjera. Ky mund të kryhet nga rrjeti i brendshëm ose i jashtëm.

White box testing

Testeri ka njohuri të plota mbi konfigurimin e rrjetit të testimit. Zakonisht ky testim kryhet nga brenda. White box kërkon një kuptim të thellë të rrjetit apo sistemit dhe jep rezultatet më të mira. Sfida kryesore me këtë lloj testimi është analizimi i sasisë masive të të dhënave në dispozicion për të identifikuar pikat e mundshme të dobësisë, duke e bërë atë llojin e testimit që konsumon kohë më së shumti.

3.6 Web Application Penetration Test

Web Application Penetration Test është procesi që teston një webfaqe apo web aplikacion duke përdorur teste manuale ose automatike të penetrimit për të identifikuar ndonjë dobësi, të meta të sigurisë ose kërcënim. Testimi përfshin përdorimin apo implementimin e ndonjë sulmi të njohur në aplikacion. Testeri fabrikon sulme dhe mjedis prej perspektivës së sulmuesit, sikur përdorimin e testimeve me SQL Injection. Qëllimi kyq i web application penetration testing është të identifikojë dobësi të sigurisë përgjatë gjithë rrjetit të web aplikacionit the komponenteve të tij (source code, databazë, dhe rrjetin back-end). Poashtu ndihmon që të prioritizohen dobësitë e identifikuara, dhe mënyrat për t'i mënjanuar ato. Pra, dobësinë më të madhe që ekziston, testimi do ta shfaq në fillim të raportit.

3.7 Web vulnerabilities

Një dobësi e webfaqes (web vulnerability) është një dobësi apo keq-konfigurim në një kod të webfaqes ose web aplikacionit që lejon sulmuesin të përfitojë kontroll mbi faqen dhe ndoshta host serverin. Shumica e dobësive shfrytëzohen përmes mjeteve të automatizuara, si vulnerability scanners apo botnets. Kriminelët kibernetik krijojnë mjete të specializuara për kërkim në internet të platformave të caktuara, duke shikuar për dobësi të zakonshme dhe të publikuara. Pasi të gjenden, këto dobësi shfrytëzohen më pas për të vjedhur të dhëna, për të shpërndarë përmbajtje me qëllim të keq ose për të injektuar dëmtime dhe përmbajtje spam në faqen e dobët.

3.7.1 Tipet e Web vulnerabilities

Sipas OWASP - Open Web Application Security Project, ekzistojnë dhjetë lloje të zakonshme të dobësive në websajte dhe internet, të cilat shfrytëzohen nga sulmuesit. Përderisa këto nuk janë të gjitha dobësitë e mundshme që një sulmues mund të gjejë në një aplikacion, por përfshihen më të shpeshtat që gjenden sot në internet. Disa prej tyre janë:

1. **SQL Injection:**

   Kjo është një dobësi e sigurisë që lejon një sulmues të ndryshojë deklaratat e backend SQL duke manipuluar të dhënat e plotësuara nga përdoruesi.

   - Një sulmues mund të injektojë përmbajtje me qëllim të keq në fushat e rrezikuara.
   - Të dhënat e ndjeshme si Emrat e Përdoruesit, Fjalëkalimet etj. mund të lexohen nga baza e të dhënave.
   - Të dhënat e bazës së të dhënave mund të modifikohen (Insert / Update / Delete).
   - Operacionet e Administratës mund të ekzekutohen në bazën e të dhënave

2. **Cross Site Scripting (XSS):**

   Dobësitë e XSS synojnë skriptet e futura në një faqe që ekzekutohen në anën e klientit, përkatësisht në shfletuesin e përdoruesit dhe jo në anën e serverit. Këto defekte mund të ndodhin kur aplikacioni merr të dhëna të pasigurta dhe i dërgon në shfletuesin e internetit pa miratimin e duhur.

- Duke përdorur këtë dobësi të sigurisë, një sulmues mund të injektojë skripta në aplikacion, mund të vjedhë cookies të sesionit, të fshijë faqet e internetit dhe mund të shkarkojë programe malware në makinat e viktimave.

3. **Cross Site Request Forgery**

   Sulmi CSRF është një sulm që ndodh kur një faqe interneti me qëllim të keq, një email ose një program i shkakton një shfletuesi të përdoruesit për të kryer një veprim të padëshiruar në një vend të besuar për të cilin përdoruesi aktualisht është i vërtetuar. Një lidhje do të dërgohet nga sulmuesi tek viktima kur përdoruesi klikon në URL dhe pasi të futet në faqen origjinale të internetit, të dhënat do të vidhen nga aty.

   - Duke përdorur këtë dobësi si një sulmues mund të ndryshohet informacioni i profilit të përdoruesit, ndryshohet statusi, krijohet një përdorues i ri për emrin e administratorit, etj.

3.8 Vulnerability scanners

Një vulnerability scanner apo skaneri i dobësive është një program kompjuterik i dizajnuar për të testuar dhe vlerësuar kompjuterët, sistemet kompjuterike, rrjetet ose aplikacionet për dobësi të njohura. Nëse vrimat e sigurisë zbulohen nga skaneri i dobësive, mund të kërkohet zbulimi i nivelit të cenueshmërisë. Personi ose organizata që zbulon dobësitë ose një organ përgjegjës si Ekipi i Gatishmërisë për Emergjenca Kompjuterike (CERT), mund të bëjë zbulimin, nganjëherë pas njoftimit të klientit dhe i lejon atyre një kohë të caktuar për të korrigjuar ose zbutur problemin. Ekziston një numër i madh i këtyre programeve komerciale dhe open source, dhe të gjitha këto kanë përparësitë apo dobësitë e veta, varësisht nga lloji dhe sistemi që punojnë. Disa prej programeve më të njohura për skanim janë:

- Acunetix, Nessus, Nmap, Burp Suite, Netsparker, N-Stealth, Nikto, Vega etj.

3.9 Krahasimi i mjeteve dhe metodave ekzistuese

Pasi që kemi shumë lloje të mjeteve për të bërë një testim, natyrisht se ato dallojnë mes vete për mënyrën se si bëhet testimi dhe njëkohësisht rezultatin apo sasinë e informatave që tregojnë në fund. Me një kërkim të thjeshtë në internet mund të gjejmë open source tools (mjete që janë të lira për këdo), por shumica prej tyre vijnë me një periudhë të caktuar kohore që mund të punojnë pa pagesë. Kjo do të ndikojë që testimi jonë të jetë më i thjeshtë dhe pa ndërlikime, por gjithsesi se do t'i tregojë dobësitë kryesore që ka sistemi apo aplikacioni.
Pra, një open source tool do të mjaftonte për një testim personal të sistemit apo faqes tuaj.
Në anën tjetër, programet komerciale që vijnë me pagesë ofrojnë shumë më tepër opsione dhe shërbime rreth testimit dhe rezultateve finale. Këto përdoren nga testuesit profesional që angazhohen për gjetjen e dobësive në organizata dhe kompani të mëdha.

3.9.1 Windows vs. Linux vs. MacOS

Disa mjete punojnë në mënyrë të barabartë në të dyja sistemet, derisa ka mjete tjera që janë lansuar vetëm për njërën nga këto platforma. Në qoftë se vendosni të punoni në vetëm një OS (Sistem Operativ) p.sh. në Windows, do të humbni shumë nga mjetet dhe teknikat tepër të dobishme që gjenden në Linux. Për të rritur efikasitetin dhe për të përmirësuar rezultatin, sugjerohet që të virtualizohet një nga këto dy OS. Duke përdorur VMware (Virtual Machine), e cila aktivizon një OS brenda sistemit aktual, dhe duke drejtuar të dyja në të njëjtën kohë në të njëjtin harduer ju mundëson që të kaloni shpejt nga Windows në Linux dhe anasjelltas.
Në anën tjetër, MacOS është një platformë shumë stabile nga aspekti i sigurisë dhe lehtë e përdorueshme. Mjetet si Nmap dhe Nikto mund të përdoren edhe në produktet e Apple. Megjithatë, ekzistojnë disa mjete për Linux dhe Windows që nuk mund të funksionojnë në MacOS. Përsëri edhe në këtë rast, mund të aplikoni formën e virtualizimit të një OS tjetër brenda në Mac duke përdorur VMware Fusion e cila mundëson lansimin e Windows apo Linux mbi sistemin MacOS.
Pra, jo medoemos duhet të zgjidhni vetëm njërin sistem apo paketë mjetesh, kur keni mundësi t'i kombinoni ato mes vete dhe të siguroni një performancë më të mirë të testimit dhe rezultat final sa më të detajuar.

3.9.2 Lloji i duhur i testimit

Qëllimi, rezultati, shkathtësia e nevojitur dhe kosto dallojnë mes vete në testime të ndryshme. Kompania IT Governance Ltd në Angli që kryen shërbimin e penetration test ka ofruar spjegim për llojin e duhur të testimit. Në tabelën 1 janë të paraqitura nivelet e testimit që ju përshtaten sipas buxhetit dhe nevojave teknike.

Tabela 1 – Cili nivel i Penetration Testing është i duhur për ju?

	Level 1	**Level 2**
Qëllimi	Për të përcaktuar dobësitë e mundshme dhe mënyrën se si të përmirësohen ato në rend të prioritetit.	Për të identifikuar shtrirjen e plotë të ekspozimit tuaj ndaj një hakeri, të dhënat që mund të ketë akses ose dëmtimet që mund të shkaktojë.
Rezultati	Identifikimi dhe analizimi i dobësive në mënyrë që të bëhet një përgjigje proporcionale drejt rehabilitimit.	Ky vlerësim më i plotë i sigurisë tuaj mundëson të merrni vendime më të informuara rreth investimit në sigurimin e sistemeve kritike të biznesit tuaj.
Organizata e targetuar	Ju keni një ekspozim ndaj sulmuesve oportunistë që kërkojnë webin për targete të lehta dhe dëshironi të siguroheni përtej një vulnerability scan.	Aplikacioni juaj bartë të dhëna të ndjeshme ose personale dhe kryen një rol kritik për misionin në biznesin tuaj dhe mund të ekspozohet ndaj një sulmi.
Niveli i shkathtësisë	Lartë	Avancuar
Imiton një sulm real	Rikrijon fazat e hershme të një sulmi, duke ju ndihmuar që të rrini jashtë radarëve të hakerëve.	Emulim i plotë i një sulmi në web aplikacionin tuaj për nxjerrjen e të dhënave ose dëmtimin e besimit të përdoruesit.
Objektivi	Marrëveshje në fillim	Marrëveshje në fillim
Paketë me çmim fiks	Po	Jo
Thirrja e zbulumit me këshillues	Në dispozicion	Po
Metodologjia e testimit	Qasje e drejtuar nga kërcënimet	Qasje e drejtuar nga kërcënimet
Skanimi i dobësive	Po	Po
Mund të kryhet në vend	Po	Po
Mund të kryhet nga distanca	Po	Po
Identifikimi i false positive	Po	Po
Shfrytëzimi i dobësive	Jo	Po
Raport i detajuar	Po	Po
Vlerësimi manual i rrezikut dhe ndikimit	Po	Po

3.10 Vulnerability Assessment and Penetration Testing Tools

Secili mjet ka përparësitë e veta, por pasi gjendet një numër i madh i tyre në dispozicion, gjithsesi se duhet të veçohen disa mjete që funksionojnë më mirë apo më shpejtë se të tjerat. Në tabelën 2 kemi të paraqitura programet dhe mjetet më të sofistikuara që gjenden në tregun e sotëm, përshkrimet për llojin e licensës që nevojitet, përdorimin e tyre si dhe sistemin operativ mbi të cilin mund të funksionojnë ato. Cross-platform do të thotë që programi në fjalë funksionon në të gjitha sistemet operative që janë cekur më lart.

Tabela 2 – Mjetet e Vulnerability Assessment dhe Penetration Testing

Nr.	Emri	Licensa	Tipi	Sistemi Operativ
1.	Metasploit	Commercial	Vulnerability scanner and exploit	Cross-platform
2.	Nessus	Commercial	Vulnerability scanner	Cross-platform
3.	Kali Linux	Open Source	Collection of various tools	Linux
4.	Acunetix	Commercial/Free (limited)	Web application vulnerability scanner	Windows
5.	Burp Suite	Commercial/Free (limited)	Web application vulnerability scanner	Cross-platform
6.	Nmap	Open Source	Vulnerability scanner and exploit	Cross-platform
7.	N-Stealth	Commercial	Web application vulnerability scanner	Windows
8.	Netsparker	Commercial/Free (limited)	Web application vulnerability scanner	Windows
9.	OpenVAS	Open Source	Vulnerability scanner	Windows, Linux
10.	Vega	Open Source	Web application vulnerability scanner	Cross-platform
11.	Nikto	Open Source	Web application vulnerability scanner	Unix, Linux
12.	Wireshark	Open Source	Network scanner	Cross-platform
13.	Sqlmap	Open Source	Database vulnerab. scanner and exploit	Cross-platform
14.	OWASP ZAP	Open Source	Web application vulnerability scanner	Cross-platform
15.	Aircrack-ng	Open Source	Wi-Fi network security scanner	Cross-platform

4. RASTI I STUDIMIT – Web Application Penetration Testing

4.1 Procesi i Web Penetration Testing

Pasi që kemi marrur programin dhe jemi regjistruar, në këtë rast me programin Acunetix fillojmë procesin e testimit të webfaqes së dëshiruar. Në anën e majtë të menu, zgjedhim **Targets** e cila përmban listën e faqeve të testuara më herët dhe mundësinë e shtimit të targeteve të reja. Klikojmë butonin **Add Target** dhe fillimisht shkruajmë URL e webfaqes, pastaj zgjedhim llojin e Skanimit, opsionet e të cilit shihen në Figurën 6.

Vazhdojmë me llojin e Raportit që dëshirojmë të shohim në fund (Affected Items, Developer, Executive Summary, Quick). Klikojmë butonin **Create Scan** dhe kështu kemi filluar skanimin apo testimin e faqes së caktuar.



Figura 4 – Add Target

Figura 5 – Vendosja e URL të webfaqes



Figura 6 – Zgjedhja e llojit të Skanimit dhe Raportit



Figura 7 – Penetration Testing në progres

Procesi i testimit nuk ka kohëzgjatje të caktuar. Varësisht nga përmbajtja e faqes ai mund të jetë disa minutësh apo disa orësh. Gjatë procesit, mund të shikojmë Requests që dërgohen në server dhe kohën mesatare të përgjigjeve që mirren.

Butonat **Vulnerabilities** dhe **Site Structure** tregojnë listën e dobësive në kohë reale sapo të zbulohen si dhe strukturën apo formën që ato kanë brenda në webfaqe.

Butoni **Events** përmban informata shtesë rreth kohës kur ka nisur skanimi.

Target Information jep të dhëna si: emri i webfaqes, lloji i serverit që mban faqen, sistemi operativ dhe a është webfaqja responsive apo jo.

Latest alerts tregon numrin e dobësive për nivelet High, Medium, Low dhe Informational.

Tashmë në skanim të thellë, në figurën 7 shohim se testimi ka dërguar mbi 100 mijë requests dhe ka gjetur 7 dobësi të nivelit të lartë (High), 1 mesatare (Medium), 1 të ulët (Low), dhe mbi 200 Informational, ku këto të fundit nuk paraqesin ndonjë rrezik të theksuar.

Pasi të ketë përfunduar skanimi, klikojmë butonin **Generate Report** dhe programi përgatit raportin të cilin mund ta shkarkojmë në formatin PDF.

Edhe nëse gjatë procesit kemi klikuar butonin **Stop Scan**, prap kemi mundësi që të gjenerojmë raport i cili paraqet të gjitha që janë gjetur deri në momentin e ndaljes. Megjithatë, kjo metodë nuk rekomandohet pasi mund të humbasim ndonjë informacion të vlefshëm.

4.2 Përmbledhje e targeteve të testuara

Me lejen e pronarëve të tyre, për këtë rast të studimit janë testuar disa webfaqe për dobësi (vulnerabilities) përmes programit NetSparker dhe Acunetix.
